

VEPNDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I  
**FERGJITHSHËM PENAL**, me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe me zyrtaren ligjore Kadishe  
 Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj, për shkak të  
 [REDACTED] penale cenim i të drejtave në marrëdhëniet punës nga neni 221 të KPRK-së, sipas  
 aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.5/2014 të dt. 16.09.2015, pas  
 mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të  
 Shtetit Ismet Rrahmani si dhe të pandehurit [REDACTED], me datë 25 Shtator 2017 mori dhe  
 publikisht komunikoi këtë:

### AKT GJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna  
 [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me vendbanim ne Rr. “ [REDACTED] ” nr. [REDACTED], i martuar  
 prind i katër fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar,  
 Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Se gjatë Muajit Korrik 2013 deri në muajin Tetor 2013, në ndërmarrjen e tij “ [REDACTED] ”,  
 në Fshatin [REDACTED] K. [REDACTED], me vetëdije duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e  
 nenit 7 dhe 23 par. 3 të Ligjit të punës së Kosovës, në atë mënyrë që ka punësuar të miturën  
 [REDACTED] e moshës 13 vjeçe që të punojë në lokalin-restorantin e tij si valltare dhe atë  
 gjatë punës së natës edhe pse një punë e tillë është e ndaluar.

me të cilën kreu veprën penale cenim i të drejtave në marrëdhëniet e punës nga neni  
 221 të KPRK-së.

Andaj, në bazë nenit 221 dhe neneve 4, 7, 17, 23, 31, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 të  
 KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së,

## G J Y K O N

- **DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 9 /nëntë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.**
- **Ne dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga nata 04.02.2014 deri më datën 03.11.2014.**
- **E dëmtuara, [REDAKTUAR] me përfaqësuesin e tij ligjor, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.**
- **Obligohet i pandehuri që të paguaj, paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, në afatin prej 30 ditëve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**

## A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për të Mitur, me aktakuzën të evidentuar PP/I.nr.5/2014 të dt. 16.09.2015, ka ngarkuar të pandehurit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për veprën penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçe nga neni 235 par. 1 nënpar. 1.1 të KPRK-së, [REDAKTUAR] për tri vepra penale edhe atë mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, veprës penale shmangi nga tatimi nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, si dhe veprës penale cenim i të drejtave në marrëdhëniet e punës nga neni 221 të KPRK-

së, si dhe ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale cenim i te drejtave në marrëdhëniet e punës nga neni 221 të KPRK-së.

Bazuar ne aktvendimin PKR.nr.163/2015 dt. 06.10.2015, ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale cenim i te drejtave në marrëdhëniet e punës nga neni 221 të KPRK-së, është veçuar procedura penale për shkak te kompetencës lëndorë dhe ndaj këtij te pandehuri te procedohet ne departament te përgjithshëm penal.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25 Shtator 2017, në të cilën shqyrtim gjyqësor i akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar: *e pranoj veprën penale për te cilën me ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, si dhe i njëjti gjatë dhënies se mendimit mbi pranimin e fajësisë shton se i vjen keqe për këtë vepër penale, ndihet thellë i penduar i premtos gjykatës se nuk do të përsëritet, ka mbyll lokalit nga viti 2013 dhe nga ajo kohë nuk ka hapë, është mbajtes i familjes, prind i kate fëmijëve dhe është i përkushtuar ndaj fëmijëve, më tutje shton se nga ajo kohë nuk ka ra ndesh me ligjin, kërkon falje publike kurse gjate matjes se dënimit kërkon nga gjykata ti këtë parasysh këto rrethana dhe ti shqiptoj një dënim sa me i butë.*

Prokurori i shteti Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë seancës fillestare si dhe në procedurën paraprake hetimore dhënë në prokurori me dt. 13.03.2014, deklarata e të dëmtuarës [REDAKTUAR] dhënë me dt. 20.03.2014, deklarata e te pandehurit [REDAKTUAR] (i gjykuar me vendim te formës se prerë) dhënë ne prokurori me dt.

12.30.2014, si dhe fotografit të cilat gjenden ne shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se te akuzuarit kane pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si G.JA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale cenim i te drejtave në marrëdhëniet e punës nga neni 221 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri me dashje ne lokalin e muzikes live-gjallë, e cila gjendet në fshatin Lloshkobare K. Ferizaj, me vetëdije te plot dhe i përgjegjshëm per veprimet e tij ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 dhe 23 par. 3 të Ligjit të Punës së Kosovës, në atë mënyrë që ka punësuar të miturën [REDACTED] e moshës 13<sup>8</sup> vjeçe që të punojë në lokalin e muzikës si valltare dhe atë gjatë punës së natës edhe pse një punë e tillë është e ndaluar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, mbajtës i familjes, moshën e tij, sjelljen e tij korrekte ne procedurë, ndërsa si rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, vlerësoj edhe atë se ka punësuar nje të mitur te gjinisë femrore që si pasoj mund te këtë stagnim ne mirëqenien psikosociale dhe edukativo arsimore.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se te akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj në shume prej 30 €, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**P.nr.1174/16, me datë 25.09.2017.**

**Zyrtare Ligjore**

**Kadishe Shabani**

**Gjyqtari i Hiri BYTYQI**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.